



Informacion për persona në kontakt të afërt me njerëzit veçanërisht të prekshëm

Pse duhet të vaksinohem?

- Ne rekomandojmë vaksinimin kundër COVID-19 për të gjithë personat 12 vjeç e lart. Ne rekomandojmë vaksinimin kundër COVID-19 edhe për fëmijët e moshës 5 deri 11 vjeç (shih fletën udhëzuese «*Vaksinimi kundër COVID-19 për fëmijët e moshës 5 deri 11 vjeç*» (anglisht)).
- Vaksinimi ju mbron nga sëmundja COVID-19. Zakonisht është i butë, por ndonjëherë ka simptoma të rënda. Vaksinimi ju mbron posaçërisht nga një sëmundje e rëndë COVID-19 me shtrim në spital.
- Kjo mbrojtje përmes vaksinimit nga sëmundjet e rënda mund të bie pak në varësi të variantit të virusit dhe posaçërisht tek personat më të moshuar. Të gjithë personave mbi 12 vjeç u rekomandojmë një vaksinim përforcues duke filluar 4 muaj pas një vaksinimi të plotë. Vaksinimi përforcues e rrit dhe e zgjat mbrojtjen nga COVID-19 (shih fletën udhëzuese «*Vaksinimi përforcues me një vaksinë mRNA*»).
- Pas një sëmundjeje COVID-19, mund të ndodhin pasoja shëndetësore të përhershme (për shembull vështirësi në frymëmarrje gjatë aktiviteteve të vështira ose lodhjes). Kjo gjithashtu mund të ndodhë në njerëz të rinj, të shëndetshëm. Duke u vaksinuar, ju ulni shumë rrezikun e sëmundjes dhe pasojat e saj.
- Me vaksinimin ndaj COVID-19, ju qëndroni të shëndetshëm dhe mund të kujdeseni për njerëzit në rrezik të veçantë, profesionalisht ose privatisht.
- Pas vaksinimit të plotë zvogëlohet ndjeshëm mundësia që ju të infektoheni me koronavirus dhe si rezultat zvogëlohet edhe rreziku i transmetimit të tij. Sado, vaksinimi nuk jep një mbrojtje njëqind për qind dhe mbrojtja bie me kalimin e kohës. Efekti mbrojtës dhe shpejtësia, me të cilën bie, mund të ndryshojnë sipas variantit të virusit. Vaksinimi dhe vaksinimi përforcues pakësojnë të paktën përkohësisht rrezikun e transmetimit të koronavirusit – kështu ju mund të mbronin personat me rrezik veçanërisht të lartë në familje, shtëpi ose punën tuaj.
- Në Zvicër vaksinat e miratuara janë të sigurta dhe efikase.

Ka njerëz për të cilët koronavirusi është veçanërisht i rrezikshëm. Në skenarin më të keq, COVID-19 mund të jetë fatal për këta njerëz. Pra, nëse jeni në kontakt të afërt me njerëz veçanërisht të prekshëm, është mirë të vaksinoheni. Kjo për shkak se vaksinimi nuk funksionon aq mirë për çdo person të vaksinuar. Veçanërisht te personat me një sistem të dobët imunitar efektshmëria e vaksinimit është ndoshta më e ulët. Për arsye mjekësore, jo të gjithë njerëzit që janë veçanërisht të rrezikuar mund të vaksinohen kundër COVID-19.

Kush janë këta njerëz veçanërisht të prekshëm?

- Personat mbi moshën 65 vjeç
- Gratë shtatzëna
- Të rriturit me Trisomie 21
- Të rriturit me lloje të caktuara të sëmundjeve kronike të mëposhtme¹
 - Presion i lartë të gjakut
 - Sëmundje kardiovaskulare
 - Diabet
 - Sëmundje të mushkërive dhe të frymëmarrjes
 - Kancer
 - Sëmundje dhe terapi që dobësojnë sistemin imunitar
 - Obezitet (BMI ≥ 35 kg/m²)
 - Insuficencë renale
 - Cirrozë e mëlçisë

A jam unë një “person i afërt kontakti”?

Ju jeni në kontakt të afërt nëse jetoni në të njëjtën shtëpi me dikë që është veçanërisht në rrezik. Ose nëse kujdeseni për të afërmit veçanërisht të prekshëm.

Ju jeni gjithashtu një kontakt i afërt nëse jeni në kontakt me njerëz që janë veçanërisht në rrezik për arsye profesionale. Për shembull, nëse jeni infermiere ose mjek i familjes, punoni në një spital, në Spitex, në një azil për të moshuar ose në një institucion për persona me aftësi të kufizuara ose punoni si ndihmës personal.

¹ Lista e hollësishme e sëmundjeve mund të gjendet në:
Categories of persons at especially high risk (PDF, 205 kB)



Është vaksinimi efikas dhe i sigurt?

Çdo vaksinë ka nevojë për miratim në Zvicër. Për ta bërë këtë, ajo duhet të plotësojë standarde të larta për sigurinë, efikasitetin dhe cilësinë. Agjencia Zvicerane për Produkte Terapeutike, Swissmedic, ka ekzaminuar dhe miratuar me kujdes vaksinat kundër COVID-19. Ajo është e sigurt dhe efikase. Dhjetëra mijëra njerëz tashmë kanë marrë vaksinën mRNA gjatë punës kërkimore. Është gjithashtu e sigurt dhe efikase tek të moshuarit edhe me sëmundje kronike. Disa miliarda njerëz janë vaksinuar me këto vaksina që nga miratimi i saj. Profesionistët vazhdojnë të monitorojnë sigurinë dhe efikasitetin e vaksinave. Përdorimi i një vaccine duhet t'i tejkalojë në mënyrë të qartë rreziqet. Vetëm pas kësaj kjo vaksinë rekomandohet në Zvicër.

Ku mund të vaksinohem?

Qeveria federale ka hartuar një strategji dhe rekomandime për vaksinimin. Kantonet janë përgjegjëse për vaksinimin. Zbuloni në faqen e internetit ose në linjën e informacionit në kantonin tuaj www.foph-coronavirus.ch/cantons, (anglisht), se ku mund të vaksinoheni. Ose pyesni mjeken, mjekun tuaj, farmacisten apo farmacistin tuaj.

A mund të vaksinohem, nëse jam shtatzënë ose nëse dëshiroj të mbetem shtatzënë?

Ne ju rekomandojmë vaksinimin kundër Covid-19 me një vaksinë mRNA përpara ose gjatë shtatzënisë. Planifikoni të mbeteni shtatzënë? Atëherë vaksinohuni sa më shpejt që të jetë e mundur. Ju tashmë jeni shtatzënë dhe nuk keni bërë ende asnjë vaksinim përpara shtatzënisë? Atëherë ju rekomandojmë vaksinimin pas 12 javësh të shtatzënisë (d.m.th. pas tremujorit të 2-të të shtatzënisë). Ajo është e mundur në parim por edhe më herët në shtatzëni.

Nëse jeni shtatzënë ose planifikoni një shtatzëni dhe keni pyetje për vaksinimin, flisni me mjeken, mjekun tuaj ose maminë tuaj.

Cilëve persona u rekomandohet cila vaksinë?

Të gjithë personave mbi 12 vjeç u rekomandojmë në përgjithësi vaksinimin me një vaksinë mRNA. Këto vaksina ofrojnë mbrojtjen më të mirë të mundshme nga një sëmundje me Covid-19 dhe pasojat e saj të mundshme. Personave nën 30 vjeç u rekomandohet mundësisht vaksinimi me vaksinën nga Pfizer/BioNTech. Për fëmijët nga 5 deri 11 vjeç lejohet dhe rekomandohet vetëm vaksina apostafat për fëmijët nga Pfizer/BioNTech. Personat mbi 18 vjeç, të cilët për arsye mjekësore nuk mund të vaksinohen me vaksinën mRNA ose i refuzojnë vaksinat mRNA mund të vaksinohen edhe me vaksinën vektor të Janssen. Kujdes: Gratë shtatzëna dhe gratë që japin gji dhe personat me një sistem të dobët imunitar duhet të vaksinohen mundësisht me një vaksinë mRNA.

Kush nuk duhet të vaksinohet?

Ne nuk u rekomandojmë vaksinimin kundër COVID-19 me një vaksinë mRNA këtyre njerëzve:

- Njerëzve me alergji të rëndë të konfirmuar ndaj cilitdo përbërës të vaksinës veçanërisht polietilen glikolit (PEG) ose trometaminë (TRIS).
Ju lutem konsultohuni me një alergologe, një alergolog².
- Fëmijëve nën 5 vjeç. Deri më tani nuk ka të dhëna për vaksinimin.

Ku mund të gjej unë më shumë informacion?

Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin kundër COVID-19 mund të gjenden në faqen e internetit të BAG: www.foph-coronavirus.ch/vaccination (anglisht) Ose pyesni mjeken, mjekun tuaj. Ose në farmacinë tuaj.

² Personat, të cilët për arsye mjekësore nuk lejohet të bëjnë vaksina mRNA, mund të vaksinohen në të gjitha rastet në marrëveshje me mjeken ose mjekun me vaksinën vektor të Janssen.

